

Kategoria Superiore/ Lushnja – Teuta 1-1

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 02 Tetor 2013 22:11



Lushnja dhe Teuta kane ndare mes tyre nje pike qe me teper ka kenaqur durrsaket sesa vendasit. Lagunaret kane pretendime per nje 11-metersh te padhen ne pjesen e pare ndersa Teuta ka marre nje pike te cmuar ne transferte duke mos njohur akoma asnje humbje ne kampionat. Te paret kane shenuar lagunaret me ane te Korreshit por durrsaket kane barazuar me pas me ane te sulmuesit te zakonshem Daniel Xhafaj. Ndeshja me pas eshte karakterizuar nga nje loje me e mire e Teutes dhe nga nje mbyllje ne mbrojtje dhe disa kundertilme nga lojtaret e Lushnjes. Ne stadiumin Roza Haxhiu kane qene te pranishem pese mije tifoz por ne fund ata nuk jane kenaqur nga barazimi 1-1 qe skuadra e tyre mori.